

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO POLJE



Ekstrakt nga procesverbali, mbledhja e tretë, e mbajtur me datën 24.03.2022, ora 10:00h, në Sallën e Kuvendit të Komunës.

Prezentë në mbledhje ishin anëtarët e Kuvendit të Komunës: Ali Ismaili - Kryesues i Kuvendit të Komunës, Remzi Shala, Mirlinda Krasniqi, Miranda Shabani, Jetmir Berisha, Vjollca Konjusha, Krenar Dumani, Laureat Gojnovci, Jahush Krasniqi, Fisnik Sllamniku, Etnik Berjani, Durim Hajra, Eglantina Azemi, Shpend Bardiqi, Habib Mekolli, Vlonjat Hasani, Hasime Kostanica, Mirsad Qyqalla, Dardane Sogojeva Shala, Aida Alimi, Migjen Kolshi, Qëndresa Ademi, Driton Ademi, Hasan Ismajli dhe Radoman Doderovic.

Mungojnë: Bashkim Krasniqi - Zëvendës Kryesues i Kuvendit të Komunës për Komunitete dhe Artan Asllani.

Kryetari i Komunës dhe Drejtorët e Drejtorive të Komunës: Fadil Krasniqi - Nënkryetar i Komunës, Amir Bullatovci - Drejtor për Administratë, Samir Shahini - Drejtor për Arsim, Mimoza Kolshi - Drejtoreshë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Maliq Berisha - Drejtor për Shërbime Publike dhe Mjedis, Ekrem Berjani - Drejtor për Zhvillim Ekonomik dhe Arbër Statovci - Drejtor për Inspektorat.

Të tjerë: Përfaqësuesit e Shoqërisë Civile.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës përshëndeti të pranishmit në mbledhje, pas verifikimit të prezencës së anëtarëve të Kuvendit të Komunës, konstatoi se ekziston kuorumi për mbajtjen e mbledhjes dhe prezantoi këtë:

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës të datës 28.02.2022.
2. Pyetje dhe përgjigje parlamentare.
3. Propozim për ndryshim-plotësimin e Rregullores për organizimin kompetencat dhe përgjegjësitë e organeve të Administratës Komunale.
4. Propozim për themelimin e Komitetit për Planifikim Urban Infrastrukturë dhe Shërbime Publike.
5. Propozim për themelimin e Komitetit për Bujqësi Mjedis dhe Ujëra.
6. Propozim për formimin e Komisionit për emërtimin e rrugëve.
7. Propozim për zgjedhjen e Komisionit për përzgjedhjen e Zëvendës drejtorit të Shkollës.
8. Propozim për lirim të subjekteve afariste nga taksat e biznesit për vitin 2022.
9. Informatë krahasuese për gjendjen e përgjithshme të sigurisë nga Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi.
10. Të ndryshme, shqyrtimi i rekomandimeve nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa: Propozimit për rishqyrtimin e vendimit Nr 22, të datës 07.02.2022 për themelimin

e tre Drejtorateve të reja Komunale, Propozimit për rishqyrtimin e vendimit Nr. 21, të datës 07.02.2022, për emërimin e Nënkyetarit të Komunës për Komunitete dhe Propozimit për rishqyrtimin e vendimit Nr. 55, të datës 07.03.2022, për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale për ndërtimin e Stacionin të Policisë në Komunën e Fushë-Kosovës, për raste të veçanta.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës përshëndeti të gjithë të pranishmit në mbledhje, lexoi pikat e rendit të ditës për shqyrtim në mbledhjen e sotme, si dhe e informoi Kuvendin e Komunës për rekomandimet e dalura nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, lidhur me rishqyrtimin e vendimeve Nr. 21, të datës 07.02.2022, Nr. 22, të datës 07.02.2022 dhe përmrësimin e vendimit Nr. 55, të datës 07.03.2022, për ndarjen e lokacionit për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale për Stacionin e Policisë në Fushë-Kosovë, për raste të veçanta dhe caktimin e periudhës kohore prej 99 viteve, ju njoftoi se për këtë çështje janë të njoftuar Shefat e Grupeve Parlamentare të tre subjeteve politike.

Durim Hajra: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. U theksua nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, se do t'i kemi në rishqyrtim tre vendime në kuadër të pikës të ndryshme, të cilat është dashur të jenë në rendin e ditës si pika të rregullta.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Lidhur me këtë punë, do të veprojmë ndryshe në të ardhmen. Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për aprovim rendin e ditës së propozuar për shqyrtim në mbledhjen e sotme, me tre pika shtesë për rishqyrtimin e vendimeve. U votua unanimisht nga të pranishmit, gjithsej njëzet e pesë anëtarë të pranishëm. Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me unanimitet të votave, e aprovoi për shqyrtim rendin e ditës së propozuar për mbledhjen e sotme, me tre pika shtesë për rishqyrtimin e vendimeve.

Pika e parë (1) - Aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës e datës 28.02.2022.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim 'ekstraktin e procesverbalit' nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës, e mbajtur me datën 28.02.2022, me sugjerimin që ju të paraqitni vërejtjet apo sugjerimet tuaja, për diskutimet dhe përmbajtjen e ekstraktit të procesverbalit. Hap diskutimin.

Durim Hajra: Lidhur me ekstraktin e procesverbalit ne do të votojmë kundër, meqë nuk janë duke u publikuar audioincizimet e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës. Mos siguri i pajisjeve për audioincizim për neve si opozitë, është i pa arsyeshëm dhe pa ndonjë sens, andaj ne do ta bëjmë incizimin e fjalimeve tona, sepse nuk po shohim ndonjë mundësi tjetër.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Për të mos e përsëritur atë që e theksova, edhe në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, por shkurt e kemi një fond, prej dhjetë mijë eurove për këtë punë, por kjo punë është e ndërlidhur me bartjen e pesë milion eurove, unë kam menduar se kjo punë është e lehtë, por tani e kam parë se duhet të realizohen procedura të prokurimit, por ju informoi juve se për këtë ekziston vullneti i Nënkyetarit të Komunës dhe Drejtorit të Drejtorisë së Administratës për rregullimin e kësaj pune.

Durim Hajra: Po thuani se ekziston vullneti i mirë, por në praktikë nuk ka asgjë, ju lutem mos e ndërlidhni këtë punë me buxhetin, kjo është një lojë fjalësh, realizimi i transparencës është shumë i lehtë, sot ka shumë mundësi për realizim.

Nënkryetari i Komunës: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Kuvendi nuk ka mjete financiare për projekte kapitale fare, ka mjete financiare të planifikuara vetëm në kategorinë ekonomike të mallërave dhe shërbimeve, andaj mos e ndërlidhni këtë punë me bartjen e mjeteve financiare.

Hasan Ismajli: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë i kam disa vërejtje në ekstraktin e procesverbalit për diskutimet e mia, në faqën numër tre, kur ka deklaruar Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, pyetjet duhet të drejtohen formalisht përmes meje për Drejtoritë e Komunës, unë kam kërkuar ta dijë, se a është kjo punë e rregulluar me ndonjë rregullore, apo vetëm po kërkohet nga ju, si një praktikë e mirë dhe pas sqarimeve jam pajtuar për këtë metodë të punës, lidhur me pyetjet parlamentare që duhet të parashtrihen në aspektin formal. Në faqën numër katër për pyetjen lidhur me Drejtorinë e Inspektoratit, unë kam kërkuar që të rregullohet çështja e parkingjeve publike dhe private para banesave kolektive, sepse ka probleme dhe në faqën numër njëzet e gjashtë, unë e kam shpjeguar shumë qartë vendimin për shpenzimet e varrimit dhe shërbimet që duhet të realizohen, kam thënë se është një Hoxhë nga fshati Sibovc i Komunës së Obiliqit, i cili e ka të drejtën e furnizimit me dërrasa dhe qefin, në shumën e mjeteve financiare prej 35 dhe 30 euro, si dhe aty i marrin dërrasat, shumica e Këshillave të Bashkësisë Islame.

Vlonjat Hasani: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë dua të ndërlidhem me diskutimin e buxhetit, që u cekë nga Nënkryetari i Komunës, rregullimi i transparencës së punës së Kuvendit të Komunës, nuk duhet as të diskutohet, ne në fondin e Kuvendit i kemi të planifikuara tridhjetë mijë euro dhe këto kërkesa minimale, sikur publikimi i audioincizimeve dhe zërimi në sallën e Kuvendit të Komunës, duhet të rregullohen shumë shpejtë dhe pa ndonjë problem, kjo është edhe obligim ligjorë, por këtu po mungon vullneti nga Ekzekutivi i Komunës.

Nënkryetari i Komunës: Me ndarjet buxhetore nuk ka mundësi të bëhet kjo punë, sepse duhet të realizohet përmes procedurave të prokurimit, të cilat marrin kohë.

Mirsad Qyqalla: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Ne dje folëm për këtë punë, e kemi bartur shumën e mjeteve financiare prej pesë milion eurove, edhe Nënkryetari i Komunës është këtu prezentë për dy mandate në Kuvend dhe të mos realizohet një punë kaq e vogël, për mua është e pa arsyshme, këtu puna dikun qalon, nuk është teknike, por mungon vullneti për realizim.

Nënkryetari i Komunës: Ne po synojmë që ta bëjmë komplet dixhitalizimin e shërbimeve komunale, duhet ta zgjedhim një kompani profesionale, që mirret me këtë punë, në mënyrë që të mos i kemi këto probleme.

Mirsad Qyqalla: Dixhitalizimi është i mirë se ardhur, por funksionalizimi i mikrofonave në sallën e Kuvendit të Komunës, është një punë shumë e vogël dhe teknike, të mos rregullohet kjo për tetë vite, sikur kam dëgjuar nga kolegët e mi, është plotësisht e pa arsyeshme.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Ju nuk po flisni asgjë për përmbajtjen e ekstraktit të procesverbalit, problemet tjera janë të njohura për Ekzekutivin e Komunës.

Shpend Bardiqi: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Këtu po thuhet gjëra të çuditshme llaptopi e incizon mbledhjen, ndërsa mikrofonat atje bëjnë, ndërsa tek ulëset tona nuk

funksionojnë, për këtë arsye ne si Lëvizje Vetëvendosje deri në krijimin e kushteve për publikimin e audioincizimeve do ta bëjmë, incizimin e fjalimeve tona, sepse e kemi fituar besimin e qytetarëve për përfaqësim.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Po e përsëris edhe njëherë, duhet t'i kthehemi përmbajtjes për pikën në fjalë.

Driton Ademi: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Ju po flisni për ekstraktin e procesverbalit, transparencën, teleprezencën, të nderuar i kemi edhe dhjetë pika të rendit të ditës, nuk kemi nevojë të ndalemi kaq shumë në këto çështje, i jepni vërejtjet tuaja nëse keni dhe ecim tutje, ashtu sikur i dha kolegu z. Hasan Ismajli, ato i bashkangjiten procesverbalit dhe publikohen. Rregullimi i audioincizimeve është punë e Ekzekutivit të Komunës, konkretisht Drejtorisë së Administratës, këtë punë e kemi thënë me dhjetra herë.

Remzi Shala: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Sa i përket përmbajtjes së ekstraktit të procesverbalit Grupi Parlamentarë i Lidhjes Demokratike të Kosovës, nuk e ka ndonjë vërejtje, ne e pranojmë dhe aprovojmë si të tillë, por duke e rezervuar të drejtën, që secili të jep sugjerime për diskutimin e tij. Ju po e zgjatni shumë pa arsye, në ekstraktin e procesverbalit bartet vetëm thelbi i diskutimit dhe procesi i vendimarrjes.

Hasan Ismajli: Unë mendoj se për këtë punë, duhet ta kemi edhe një daktilograf sikur e kanë nëpër gjykata, sepse është e pa mundur të shënohen të gjitha fjalët që i themi ne këtu.

Vlonjat Hasani: Edhe unë i kam disa vërejtje nëpër faqe të caktuara, por tani nuk do t'i elaboroj, sepse për këtë arsye, ne po e kërkojmë publikimin e audioincizimeve të mbledhjeve për publikun e gjerë, sikur po veprohet edhe nëpër komuna tjera.

Pasi që diskutime tjera nuk pati, e qiti në votim për aprovim, ekstraktin e procesverbalit të mbledhjes së Kuvendit të Komunës të mbajtur me datën 28.02.2022, me përmirësimin e diskutimit të anëtarit të Kuvendit të Komunës z. Hasan Ismajli.

U votua me: trembëdhjetë vota 'për', dhjetë 'kundër' dhe një abstenim, gjithsej njëzet e shtatë anëtarë.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me shumicë të votave, e aprovoi ekstraktin e procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës e mbajtur me datën 28.02.2022, me përmirësimin e diskutimit të anëtarit të Kuvendit të Komunës z. Hasan Ismajli.

Pika e dytë (2) - Pyetje dhe përgjigje parlamentare

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi pikën 'Pyetje dhe përgjigje parlamentare', për të cilën e kemi kohën prej 60 minutave, ata të cilët nuk arrijnë të parashtrojnë pyetjet brenda kohës së paraparë, ato mund t'i dërgojnë me shkrim.

Durim Hajra: Tani unë në respektim të secilës çështje, më duhet t'i paraqes prapë disa pyetje për Drejtorinë e Inspektoratit tani në rrugën 'Tahir Zemaj' në Fushë-Kosovë, janë duke u bërë ndërtime të larta sikur në lagjen 'Dardania', këtu ka shumë telashe dhe shqetësime të qytetarëve

për qarkullimin e automjeteve të rënda, në afërsi të shkollës ku janë të rrezikuar edhe nxënësit. Për Drejtorinë e Planifikimit Urban rruga 'Ymer Prizreni', është dëmtuar shumë nga operatorët privat, aty ka dalur edhe rrjeti i kanalizimit në rrugë dhe kjo gjendje është kështu për tre vite rreshtë, andaj unë pyes, kur është në plan të rregullohet kjo rrugë. Për Drejtorinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, pyetja është, pse nuk ka filluar aplikimi për ndarjen e subvencioneve për fermerët e komunës tonë, tani jemi në muajin mars dhe kjo punë nuk është bërë ende, ata janë mësuar që të aplikojnë në muajin shkurt të secilit vitë për serra, motokultivatorë dhe pajisje tjera bujqësore, andaj unë pyes, sa do të ketë vonesa në këtë drejtim. Për Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Mjedisit ka problem me pastrimin e rrugëve, kjo punë është bërë një herë në vitin e parë të pandemisë, andaj kërkojmë që ta kontraktojmë një kompani për pastrimin e rrugëve, sepse tani jemi në prag të ardhjes së stinës së verës dhe ne në qytet nuk mund t'i hapim as dritaret e banesave.

Vlonjat Hasani: Unë i kam pesë pyetje, po filloj me Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Mjedisit është kërkesë e banorëve të fshatit Miradi e Epërme, që afër oborrit të shkollës të lirohet hapësira publike, e njëjta kërkesë vlen edhe për objektet publike tjera nëpër lagje të qytetit dhe fshatra. Në lagjen e Bresjes duhet të vendoset kabina për pritjen e autobusëve, aty ku sot zhvillohet tregu. Kërkoj që të rregullohet rrjeti i kanalizimit në rrugën 'Binarët' në fshatin Miradi e Epërme, aty duhet të largohen edhe mbeturinat, sepse është krijuar një deponi e egër dhe gjendja aty duhet të sanohet. Kemi probleme dhe ankesa të qytetarëve, lidhur me mosfunksionimin e ndriçimit publik në shumë lagje të qytetit dhe nëpër fshatra. Shqetësim tjetër është rrezikimi i banorëve nga qentë endacakë, e sidomos i nxënësve, andaj kjo punë e kërkon një intervenim urgjent për trajtimin e qenve endacakë. Nga Drejtoria e Inspektoratit kërkojmë, që të intervenon në ndalimin e degradimit të tokës bujqësore, nga kontraktoret e ndryshëm, që hedhin material të forta në fshatin Miradi e Epërme, për këtë punë kërkojmë të dijmë, se kur do të veprohet nga shteti dhe me bekimin e kujt është duke u bërë kjo punë. Për Drejtorinë e Planifikimit Urban, e kemi një kërkesë nga banorët e rrugës 'Lumi', në fshatin Miradi e Epërme, ku mungon rrjeti i kanalizimit, banorët paguajnë taksa por nuk po e marrin shërbimin, unë pyes, kur do të vepron për këtë çështje, sepse unë këtë punë do ta ngriti në secilën mbledhje deri sa të realizohet. Për Drejtorinë e Arsimit, pyetja ka të bëjë me shkeljet, që janë të qarta ku nxënësit në dy lëndë ekonomike në dy shkolla të mesme, po e humbin mësimin kjo është një mungesë e profesionalizmit dhe mosveprim nga Drejtoria e Arsimit, njësoj është vepruar edhe në periudhën e parë në Shkollën Filllore të Mesme të Ulët 'Vëllezërit Frashëri' në fshatin Miradi e Epërme, në lëndët Biologjisë dhe Edukatës Fizike, unë me kohë e kam shtruar problemin e notimit të nxënësve. Pyetjet tona ne do t'i paraqesim edhe në formën e shkruar ashtu siç kemi vepruar, edhe në dy muajt e kaluar.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Pyetjet e parashtruara me shkrim nga ana e juaj, unë i kam përcjellur tek Drejtorët e Drejtorateve të Komunës.

Hasan Ismaili: Unë e kam një vërejtje tek ju i nderuari Kryesues i Kuvendit të Komunës, lidhur me çështjen e thirrjes së mediave, të cilën nuk e keni bërë ju dhe tani këtu vijnë përfaqësuesit e Vetëvendosjes, me kamerë dhe bëjnë incizimin, sikur thonë ata të anëtarëve të vet kur flasin, thuajse p.sh problemet në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare 'Dr. Fatmir Krasniqi' në Fushë-Kosovë, i njohin vetëm ata, ju po i shihni se si veprojnë këta, e marrin një qantë në krah dhe

i adresojnë problemet e qytetarëve, thujasë vetëm këtyrë i'u dhëmbin ato, këta e prezantojnë veten në publik, ndërsa ne të tjerët jemi të hendikepuar sepse këta po e marrin primatin para publikut përmes publikimeve të tyre, meqë ju dhe Ekzekutivi i Komunës nuk po i sjellni mediat në mbledhje, e ne do t'i ftojme vetë. Unë e kam një kërkesë për Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe mjedisit, sepse këtë çështje e kam ngritur edhe vet kur kam qenë kandidat për Kryetar të Komunës, lidhur me hapësirën e mbetur të varrezave në qytetin e Fushë-Kosovës, aty ka mbetur një hapësirë prej 40 metra gjatësi dhe 10 metra gjerësi, kjo hapësirë për një vitë mund të mbushet me varreza të reja, halli im është të dijë, se a keni në agjentë, sigurimin e një ngastre kadastrale për varreza në Fushë-Kosovë. Unë e falënderoj Drejtorin e Inspektoratit për shqyrtimin e pyetjeve të parashtruara nga unë, lidhur me ndërtimet e larta dhe sigurimin e vendeve ku ndërtohet sipas rregullave që dihen. Pyetja tjetër ka të bëjë me lokalet afariste, ku po pihet duhani në ambiente të mbyllura, andaj kërkoj që kjo çështje të adresohet dhe zgjidhet. Për Drejtorinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit është e vërtetë, që disa salla janë ndërtuar, por ato janë jashtë përdorimit dhe në to po zhvillohen dukuri negative, nga ana e rinisë tonë, andaj kërkoj nga Drejtori që vjen nga partia ime, që të ndërmirren masa për eliminimin e këtyrë dukurive të dëmshme për shoqërinë ose këto salla të sporteve të mbyllën. Për Zëdhendësin e Komunës, e kam një vërejtje, sepse e keni bërë një deklaratë tendencioze para mediave në television, ku e keni thënë një të pavërtetë të madhe, lidhur me dhënien e dhuratave kremave për heqjen e rrudhave për nderë të Festës së 8 marsit, ku ju keni deklaruar se të gjitha femrat janë pajtuar, që t'iu jepen këto dhurata e vërteta është që ato nuk janë pyetur fare, andaj ju duhet të jeni më i kujdesshëm, të mos e dëmtoni askëndë dhe për rastin konkret duhet të kërkonj falje.

Aida Alimi: Në kuadër të aktiviteteve dhe takimeve të 'Javës për Barazi Gjimore', ne e kemi mbajtur një takim avokues, këtu në Sallën e Kuvendit të Komunës, me gratë e viseve rurale të komunës tonë, ato i kanë disa nevoja dhe kërkesa të tyre, që kanë të bëjnë me shpenzime veterinarë dhe shpenzime tjera bujqësore, unë në emër të Grupit të Grave, kërkoj nga Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, që gratë fermere të mbështeten me subvencione dhe shërbime tjera. Në aksin rrugorë të Magjistrale M9, aty ku janë hapur vendkalimet në katër vende, ne propozojmë që të vendoset sinjalistika, sepse nga profesionistët e fushës është vlerësuar, se ka rrezik të madh për këmbësorët, ne kërkojmë që kjo punë të rregullohet në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës. Çështja e ndarjes së kremave, është shndërruar pa të drejtë në një temë ofenduese, kjo punë nuk duhet të trajtohet kështu, por me këtë punë janë marrë Zyra e prokurimit e komunës, ne nuk jemi pyetur fare sikur është pohuar, por në fund kjo është një dhuratë, që nuk vlenë të komentohet më shumë.

Hasan Ismajli: Secilin vitë për nderë të 8 marsit 'Ditës së Gruasë', nga komuna janë ndarë lule, ndërsa këtë vitë femrat nuk janë pyetur fare dhe janë blerë krema për heqjen e rrudhave, kjo punë është vendosur vetëm nga disa individë. Kjo punë nuk shkonë kështu, sepse edhe në vitin 2013 nga ish/Kryetari i Komunës z. Skënder Zogaj, është thënë në një shkrim autorial se komuna është një harem, si dhe nga komuna nuk ka patur një kundër reagim apo demantë në gazetën e caktuar, përveç një reagim në ueb-faqën e komunës.

Mirsad Qyqalla: Unë e kam një pyetje për Drejtorinë e Inspektoratit, tani janë ngritur çmimet e biletave për njëzet centë nga operatorët e transportit të udhëtarëve, që për nxënësit tonë është një shumë e madhe, sepse ata udhëtojnë për ditë. Kompanitë edhe mund të kenë arsyet e veta për ngritjen e çmimeve, për arsye të rritjes së çmimit të naftës, por kjo punë nuk duhet të bëhet kështu pa një bazë dhe vlerësim nga komuna, ose komuna duhet të krijoj lehtësime për nxënësit e komunës tonë, ku mund të jenë edhe dy nxënës nga e njëjta familje dhe kjo paraqet një barrë të rëndë për buxhetin e familjeve tona. Tani nga Drejtoria e Arsimit besojmë se ka qenë një kohë e arsyeshme për skanimin e gjendjes nëpër shkollë, unë pyes a keni filluar të ndërmerri ndonjë veprim për rritjen e cilësisë në mësim, ku shumë klasë i kemi më 45 nxënës, a keni ndonjë strategji për zgjidhjen e problemeve të grumbulluara me vite. Në fshatin Bardh i Madh është blerë një filter për sigurimin e ujit për shkollë, nga një person, kjo punë është e mirë, por ne mendojmë se këtë punë në secilën shkollë duhet ta bënë vetë Drejtoria e Arsimit.

Aida Alimi: Unë në vitin 2013 kam qenë pjesë e Legjislaturës së komunës dhe unë atëherë, bashkë me doktoreshën znj. Fazile Sejdiu, kemi reaguar dhe e kemi lëshuar mbledhjen e Kuvendit të Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Kërkoi nga secili prej juve, që të mos flisni për të kaluarën, por të mirreni me të tashmen dhe problemet e qytetarëve.

Habib Mekolli: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Tani është duke u përdorë një dukuri e keqe, me shpërndarjen e fletushkave dhe reklameve, nëpër banesa të ndërtimeve kolektive nga individë dhe subjekte të caktuara afariste, ne kërkojmë nga Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Mjedisit, që të mirren masa për ndërprerjen e kësaj dukurie. Hapësirat publike duhet të pastrohen, por kjo punë nuk duhet të bëhet vetëm në një ditë, por duhet të ketë një rrjedhë kohore, njësoi duhet të mirëmbahen edhe rrugët në pjesët më të dendura të qytetit, ku frekuentimi i njerëzve është më i madhë, kjo punë të bëhet më shpeshë. Unë e kam dorëzuar një peticion për Drejtorinë e Inspektoratit për problemet në lagjen tonë, me tridhjetë nënshkrime dhe më është dashur të paguajë gjobën prej pesë euro, kjo shumë është e lartë, kjo punë duhet të rregullohet nga institucionet komunale, sepse njerëzit edhe mund të heqin dorë nga parashtrimi i peticioneve të tilla, për rregullimin e punëve në zonën e tyre të banimit, ne duhet ta nxitim një qytetari aktive që mirret me probleme. Komuna duhet ta bënë një informim për Planin e Mobilitetit, që duhet të zbatohet përmes rrugëve njëkohore në lagjen e Dardanisë. Lidhur me transparencën që u cekë nga anëtari i Kuvendit të Komunës z. Hasan Ismajli, nuk është korrekte, ne incizimin e kolegëve tonë e bëjmë për nevojat tona, meqë komuna nuk është duke e realizuar audioincizimin për publikun dhe këtë punë, ne nuk e bëjmë për vota, por sepse e kemi besimin e qytetarëve për përfaqësimin dhe jemi borxhli ndaj besimit, që na është dhënë në zgjedhje.

Hasan Ismajli: Mua po më pengon ky incizim i njëanshëm dhe i parregulltë, ajo është një marketing për juve, ndërsa ne të tjerët jemi të hendikepuar, unë jam në kualicion me Lidhjen Demokratike të Kosovës dhe zëri im duhet të dëgjohet nga qytetarët përmes mediave, e jo nga incizimet e tilla, thuaj se vetëm ju flisni këtu për problemet e qytetarëve.

Dardane Sogojeva Shala: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë e kam një kërkesë të banorëve të fshatit Sllatinë e Madhe, konkretisht të rrugës 'Shpati', ne kërkojmë të vendosen disa

ndalesa në rrugë, sepse janë të rrezikuar kalimtarët. Vetëm në kohën e fundit kanë qenë katër raste me rrezik të madh, tek marketi Albana, ku automjeti për arsye të shpejtësisë shumë të madhe ka hyrë në objektë, andaj vendosja e ndalesave aty është një domosdoshmëri.

Qëndresa Ademi: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Nga lagjet 028 dhe 029, mbeturinat nuk janë hequr për tre javë, është thënë se kjo nuk po bëhet për arsye, se banorët nuk i kanë kryerë pagesat e faturave të pastrimit, ne kërkojmë që këto mbeturina të hiqen, si dhe të bëhet hapja e rrjeteve të kanalizimeve, të cilat po mbyllen për ditë, si dhe të ketë një trajtim për qentë endacakë, që paraqesin një rrezik permanentë për fëmijët dhe nxënësit në lagjet tona.

Shpend Bardiqi: Kështu rrjedhë puna kur një çështje e karakterit lokal devijon pa nevojë, ne e bëjmë incizimin e fjalimeve tona, sepse duam ta kemi një transparencë me qytetarët, sepse për përfaqësim jemi zgjedhur, përndryshe mbledhjet e Kuvendit të Komunës janë të hapura për publikun. Ne këtu nga anëtari i Kuvendit të Komunës z. Hasan Ismajli, u tha se ne nuk kemi kulturë, unë e pyes atë, a është kulturë me vjedhë? Këtu duhet të ruhet autoriteti i Kuvendit të Komunës.

Migjen Kolshi: Të nderuarë kolegë këtu duhet të eliminohen fyerjet dhe shprehjet që po përdoren, i pakulturuarë, sepse ne e dimë, institucionet tona janë quajtur edhe me gurë nga një subjektë politikë, sa ka qenë në opozitë në nivelin qendrorë. Unë e kam një pyetje për Drejtorin e Drejtorisë së Arsimit, a kemi ndonjë ndryshim apo mundësi për pagesën e mësimdhënësve, që nuk kanë marrë paga nga muaji shtator 2021. Ndërsa nga Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Mjedisit, kërkoj që në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës, në magjistralen M9 në relacionin Fushë-Kosovë/Sllatinë e Madhe, për një kohë të gjatë nuk po funksionon ndriçimi publikë, është e nevojshme të ndriçohen lagjet e caktuara, por me rëndësi është të ndriçohet autostrada.

Remzi Shala: Në emër të Grupit Parlamentarë të Lidhjes Demokratike të Kosovës, pajtohem me mendimin e anëtarit të Kuvendit të Komunës z. Hasan Ismajli, se të gjithë duhet ta kemi prezencën e njëjtë para kamerave, të verifikohet kush janë këta persona, të paautorizuar që po e bëjnë incizimin e mbledhjes, kjo punë duhet të rregullohet deri në mbledhjen e ardhshme, si hyn këta persona në mbledhje nga Zyra e Informimit të Komunës.

Drejtori për Shërbime Publike dhe Mjedis: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Tani dua të sqaroj, se një pjesë e problemeve të ngritura nga anëtarët e Kuvendit të Komunës, janë shumë të arsyeshme, por ne nuk po kemi mundësi t'i zgjidhim, sepse kemi ankesa nga operatorët ekonomik në Organin Shqyrtues të Prokurimit, i cili nuk është funksional, i tillë është rasti me kompaninë për mirëmbajtjen e rrjeteve të kanalizimeve, ku nuk kemi kontratë valide për njëzet muaj. Rregullimi i sinjalistikës që u ngritë nga znj. Dardane Sogojeva, është plotësisht i arsyeshëm, për të mos patur ndonjë viktimë në qytet dhe fshatra, ne i kemi të planifikuar me buxhet shumën e mjeteve financiare prej: 143,000.00€, por projekti nuk mund të rishpallet për arsye të ankesave. Ne kemi punuar në disa pika më të ndieshme, sikur është rruga kryesore 'Nëna Terezë', ku është e vendosur sinjalistika horizontale, si zgjidhje më e mirë për qytetarët, e cila ka nevojë për përmirësime tjera shtesë sa po të krijohen mundësitë përmes një kontrate të re. Larjen e rrugëve e kemi bërë në fillim të pandemisë, shprortat për mbeturina janë të vendosura nëpër shkolla, neve qytetari kur e bën kërkesën, na obligon që të sigurojmë shprortat, ju informoi se kemi bërë disa herë

ndryshime, tek furnizimet me kontejnerë të mëdhenjë në fillim, pastaj me kontejnerë të plastikës për familje dhe biznese, i kemi eliminuar disa herë deponitë e egra të mbeturinave, por ato krijohen vazhdimisht. Qentë endacakë duhet të trajtohen dhe jo të eliminohen, sepse kjo punë nuk lejohet, ndriçimi publikë është përmirësuar në shumë pjesë në Fushë-Kosovë dhe nëpër rrugë lokale. Për gjetjen e një lokacioni për varreza kemi menduar, e kemi bërë gardhimin e tyre, ne shpresojmë se do ta gjejmë një pronë shoqërore, ose të shqyrtohen mundësitë ligjore për blerjen e një prone private. Me çështjen e fletushkave duhet të mirren Inspektorët e Mjedisit, aty ku kemi patur mundësi dhe pronë publike, i kemi vendosur pritoret për qytetarë që presin autobusët, ato janë të vendosura në shumicën e pikave, do të shqyrtojmë edhe kërkesën për lagjen e Bresjes. Për kërkesën e ngritur nga z. Migjen Kolshi, kjo punë nuk është në kompetencën tonë, por ne do t'i shkruajmë Ministrisë së Infrastrukturës për këtë problem që po zgjatë.

Jetmir Berisha: Përsëritet të pranishmit në mbledhje. Arsyeja kryesore që nuk janë marrë mbeturinat në lagjet e komuniteteve, ka qenë se ne kemi patur disa probleme, me një kamion, vetëm kjo është arsyeja, ju duhet t'i informoni qytetarët atje, se kjo nuk ka lidhje me pagesën e faturave. Ne i kemi pastruar disa herë lagjet tuaja, e bëjmë marrjen e rregullt të mbeturinave sipas planit dinamik të punës. Kordinimi duhet të bëhet me inkasantët, qytetarët nuk duhet të pësojnë, për arsye se dikush nuk paguanë, por ju duhet ta dini, se edhe ne jemi Kompani profitabile dhe kemi shpenzime për punëtorë dhe shpenzime tjera operative.

Drejtori për Arsimit: Përsëritet të pranishmit në mbledhje. Unë tani isha duke pritur më shumë pyetje në lidhje me arsimin, pyetja kryesore këtu u ngritë nga anëtari i Kuvendit të Komunës z. Migjen Kolshi nga Partia Demokratike e Kosovës për pagesën e mësimdhënësve, unë dua të ju informoi, se tani disa punëtorë arsimorë janë paguar dhe jemi duke kërkuar të gjejmë zgjidhje, por në këtë drejtim deri tani, nuk e kemi përkrahjen e Ministrisë së Financave Punës dhe Transfereve, për hyrjen e këtyre punëtorëve arsimorë në listën e pagave. Lidhur me pyetjen e z. Mirsad Qyqalla, ju gjendjen aktuale e dini, ne tani i kemi rreth 46 nxënës nëpër klasa, ne si komunë gjatë mandatit të kaluar zgjedhor i kemi ndërtuar dy shkolla të reja, duhet ta identifikojmë ngastrën kadastrale, edhe për ndërtimin e një shkolle të re gjatë këtij viti, përmes shpronësimit, apo përmes dhënies së bonuseve të ndërtimit. Puna jonë ka ndikuar që sot në shkollën amë 'Mihal Grameno' në Fushë-Kosovë, të jenë vetëm 1400 nxënës dhe jo tremijë nxënës, tani i kemi nga 38-40 nxënës në klasa, edhe kjo është shumë për të arritur standardet e parapara për një mësim cilësorë dhe efektiv. Uji i pishëm në shkollën e fshatit Bardh i Madh është siguruar nga një donacion dhe ne e falënderojmë donatorin, kemi punuar në furnizimin e shkollave me dezinfektues. Tani unë dua të sqaroj lidhur me konkursin për drejtor të shkollave dhe deklaramë të z. Vlonjat Hasani, i cili nuk po e thotë të vërtetën dhe po dezinformon, kur thotë se janë shkelur procedurat për zgjedhjen e drejtorëve të shkollave, me më pak se tre kandidatë, sepse ku nuk i lexon Udhëzimet Administrative në tërësi, ai i lexon vetëm në pjesë të caktuara, këto punë rregullohen me disa udhëzime administrative, konkursi është rishpallë dhe sipas rregullave të udhëzimit, procedura përfundon edhe me vetëm një kandidatë. Pasi që po kemi tentimi për njëlloshje, pa të drejtë të procesit të zgjedhjes, unë i jam përgjigjur në media ankesave të tyre dhe meqë po veproni kështu, nuk do të merrni asnjë përgjigje nga ana ime.

Vlonjat Hasani: E dëgjuat akuzën direkte ndaj meje, se unë po dezinformoi, unë ju rikujtoi juve se sipas Udhëzimit Administrativ Nr. 07/2017, me të cilin rregullohen procedurat e punësimit në sektorin publikë, neni 6, pika 5.1, nëse nuk janë tre kandidatë konkursi publikë anulohet, unë këtu po befasohem, se si e merrni guximin të dezinformoni kështu, unë vetëm i kam sqaruar procedurat e konkursit publikë.

Drejtori për Arsim: Për këto shpifje që po i bëni, unë me juve do të shihemi vetëm në gjykatë, ju nuk mund ta lexoni vetëm një Udhëzim Administrativ. Ne e kemi zbatuar në plotëni Udhëzimin Administrativ Nr. 151/2020, është bërë shpallja e dytë dhe ne nuk do të lejojmë, që ju me deklaratat tuaja të njëllosni këtë punë, ne kemi komunikuar me juve me mirësjellje, por ju nuk pranuat, andaj shihemi në forma tjera para organeve tona.

Drejtori për Inspektorat: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Së pari pyetjet e parashtruara nga anëtarët e Kuvendit të Komunës, për drejtorinë tonë, ne do t'i adresojmë dhe trajtojmë për zgjidhje. Lidhur me ndërtimet e larta në rrugën 'Tahir Zëmaj' dhe në lagjet tjera, ne u kemi dorëzuar një urdhëresë të gjithë operatorëve ekonomikë që realizojnë ndërtime të larta, se duhet t'iu përmbahen rregullave të sigurisë së ndërtimeve, në proces të ndërtimit janë shtatëdhjetë objekte në Fushë-Kosovë. Jemi duke punuar në identifikimin e atyre që bëjnë hudhjen e mbeturinave dhe krijojnë deponi ilegale. Lidhur me ankesat e z. Habib Mekolli për zhurmën, duhet të identifikoni saktë rrugën, ne jemi duke e analizuar zhurmën që po shkaktohet në lagjen e Dardanisë, sepse tani jemi, edhe në prag të stinës së verës dhe kjo dukuri do të rritet. Ka një tendencë për rritjen e çmimit të biletave nga operatorët e transportit të udhëtarëve, ne do ta ndërmarrim një aksion, për ta ndaluar këtë proces dhe do të shqiptojmë gjoba, si dhe nuk do ta lejojmë ngritjen e tyre pa një arsyeshmëri.

Laureat Gojnovci: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë debatin tim tani, do ta ndërlidhi me deklaratimet e kolegut tim z. Vlonjat Hasani, lidhur me konkursin publikë për zgjedhjen e drejtorëve të shkollave, unë kam dashur që ta ruajmë raportin kolegial ndërmjet neve, por ky është revanshuar me komunikimin e tij në media, ky nuk paraqet arsyet e bazuara dhe kjo paraqet një shqetësim për ne, ai e përmendë aty pa të drejtë zyrtaren znj. Miranda Sylejmani dhe e konteston kualifikimin e saj. Unë e di se në konkurs kanë qenë dy kandidatë dhe këtë punë e lejon ligji dhe udhëzimi administrativ. Së pari ai është dashur të kërkon informata nga Drejtoria e Arsimit, të cilat edhe i ka marrë dhe të njëjtat, ai i ka keqpërdorur në mjetet e informimit publikë dhe me këtë rast, ai vetë i ka prishur urat e bashkëpunimit.

Koha e pushimit prej: 30 minutave.

Pika e tretë (3) - Propozim për ndryshim-plotësimin e Rregullores për organizimin kompetencat dhe përgjegjësitë e organeve të Administratës Komunale.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi në shqyrtimin e parë 'Propozimin për ndryshim-plotësimin e Rregullores për organizimin kompetencat dhe përgjegjësitë e organeve të Administratës Komunale'. Hap diskutimin.

Durim Hajra: Kjo çështje nuk është shoshitur dhe analizuar si duhet, ju e dini që vendimi për themelimin e tre Drejtorateve të reja Komunale, është konfirmuar si vendim i paligjshëm nga ana e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe ju duhet t'i referoheni atij shqyrtimi, të filloni me ndryshimet në Statutin e Komunës dhe jo të Rregullores për organizimin e brendshëm, unë po habitem, pse është kjo qasje e juaja kështu, shkoni me prova të një pas njëshme, edhe pse e dini se është gabim në aspektin procedural. Statuti i Komunës ka nevojë për ndryshime në më shumë se pesëmbëdhjetë nene, e provoni i keni dy të tretat, i bëni ndryshimet dhe i themeloni drejtoritë e reja me statut. Interesi i opozitës është që Statuti i Komunës, të ndryshohet edhe në nene tjera, na bindeni dhe ne mund t'i votojmë këto ndryshime, por po shihet se këtu nuk ka vullnet politikë nga Ekzekutivi i Komunës.

Nënkryetari i Komunës: Ky është një dialogë i mirë, ne këtë punë do ta kryejmë përmes ndryshim-plotësimit të Rregullores për organizimin e brendshëm, sepse emërtimet dhe kompetencat e drejtorateve të komunës i kemi në rregulloren e vitit 2014. Statuti dhe rregullorja janë të harmonizuara, në rregullore janë të definuara edhe vendet e punës në Administratën e Komunës së Fushë-Kosovës. Vendimin që do ta marrim sot shkon për vlerësim në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbahet dëgjimi publik dhe vjen rregullorja për miratimin përfundimtarë.

Driton Ademi: Ju duhet të qëndroni në temën që shqyrtohet, e jo të mirreni me aspekte tjera, sistemi i qeverisjes lokale është autonom, sikur në Britani të Madhe dhe Gjermani, si dhe kjo punë është e ndërlidhur edhe me Kartën Evropiane për qeverisjen lokale, këtu kemi të bëjmë me një kategori kushtetuese. Sikur në nivelin qendrorë edhe në nivelin lokal pushteti funksionon nëpërmjet Ekzekutivit dhe Legjislativit, që në rastin konkret jemi ne Kuvendi i Komunës, që marrim vendime të përgjithshme për organizimin e brendshëm. Procedura janë të qarta fillohet me aktet më të larta, që është Statuti dhe Rregulloret si akte të përgjithshme, që rregullojnë fusha të caktuara. Ka një ndryshim tek organizmet e brendshme nëpër komuna të vendit tonë. Sipas nenit 43, pika (h), të statutit Kryetari i Komunës, e ka të drejtën e përcaktimit të numrit të Drejtorateve Komunale dhe kjo punë në aspektin organizativ të funksionimit në vitin 2014, është bartur në Rregulloren për organizimin kompetencat dhe përgjegjësitë e organeve të Administratës Komunale, andaj neni në të cilin thirret Kryetari i Komunës është vendimarrje. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka kërkuar që ne ta bëjmë, ndryshim-plotësimin e rregullores, vendimi ka qenë vetëm një hap fillestarë, unë i kam hulumtuar komunat, të njëjtin organizim përmes rregullores e kanë edhe Komunat e Prizrenit dhe Istogut.

Remzi Shala: Tani këtu shumica e çështjeve u thanë dhe sqaruan nga Nënkryetari i Komunës dhe kolegu z. Driton Ademi, tani ne vendimin Nr. 22, për formimin e tre Drejtorateve të reja të Komunës do ta shfuqizojmë, ato do ta bëjmë përmes ndryshim-plotësimit të Rregullores për organizimin e brendshëm, kërkesa jonë shkonë në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbahet dëgjimi publikë dhe vazhdojmë tutje, andaj në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentarë të Lidhjes Demokratike të Kosovës, propozojmë që të aprovohet në parim për diskutim publikë, 'Propozimi për ndryshim-plotësimin e Rregullores për organizimin e brendshëm të komunës'.

Mirsad Qyqalla: Ne këtë punë e kemi diskutuar shumë gjatë, edhe në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, kërkesa për drejtori të reja mund të bëhet, por këtu është shkelur procedura, nuk është filluar mbarë nga akti më i lartë i komunës, që është Statuti i Komunës, unë nuk po e kuptoi këtë nguti nga ju, duke i shkelur procedurat për hartimin e akteve të komunës, së pari është filluar gabim me vendim, prapë Nënkryetari i Komunës insiston të shkojmë me rregullore.

Durim Hajra: Ju thuani se këtë e bëni edhe për hirë të transparencës, kjo punë duhet të bëhet nga fillimi me ndryshimin e Statutit të Komunës, nëse nuk fillon kështu ne si opozitë jemi kundër. Këtu tre Drejtori të reja Komunale, janë duke u formuar politikisht për të plotësuar kërkesat politike për individë të caktuar. Vërejtjet tona janë parimore, andaj ne e kundërshtojmë këtë qasje nga ana e juaj.

Driton Ademi: Drejtoritë e Komunës duke filluar nga viti 2014, nuk janë në Statutin e Komunës, nuk janë as njëmbëdhjetë drejtoritë aktuale, as katërmëdhjetë, atëherë Kuvendi i Komunës ka qenë më demokratikë dhe ka ecur përpara. Ne e konsiderojmë të nevojshme shtimin e tre drejtorateve, ku hyn edhe procesi i dixhitalizimit të institucioneve komunale të administratës, arsimit dhe shëndetësisë, për të cilin mendojmë dhe vlerësojmë, se është i arsyeshëm tani dhe nevojitet një reformë më e thellë.

Nënkryetari i Komunës: Ne nuk e kemi ndërmend tani të fillojmë me ndryshimin e Statutit të Komunës, ju duhet të lexoni mirë kërkesën e Ministrisë, ka kërkuar që ta ndryshojmë rregulloren për organizimin e brendshëm, ne do të vazhdojmë, ndërsa verifikimin përfundimtarë e bënë organi mbikqyrës.

Durim Hajra: Mund të shtohen edhe më shumë drejtori, por kjo duhet të fillon me një bazë juridike, kjo bazë është statuti, pse nuk i hyn kësaj pune, e provoni ai keni dy të tretat e votave dhe ecim tutje, ndoshta edhe ne bindemi me argumente dhe e aprovojmë ndryshimin e statutit, edhe në disa nene tjera.

Driton Ademi: Ne duhet të respektojmë subjektet tjera politike ashtu sikur janë, por nuk duhet të lejojmë që të pengohen reformat në organizimin e brendshëm, komuna tani funksionon me vetëm një IT, ne jemi të interesuar të rrisim performancën e organeve të komunës, në shumë segmente, e sidomos në arsim dhe shëndetësi.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Kjo punë tani është e qartë, po shkojmë me aprovimin në parim të ndryshim-plotësimit të Rregullores për organizimin e brendshëm, e bëjmë në fund shfuqizimin e vendimit Nr. 21 për themelimin e Drejtorateve të reja Komunale.

Mirsad Qyqalla: U tha se Kuvendi i Komunës në vitin 2014, ka qenë më demokratike, kjo nuk qëndron, apo me çka e matni ju shkallën e demokracisë, ju po veproni në mënyrë individuale, vazhdoni në këtë mënyrë, votat i keni e zbatoni dixhitalizimin e komunës, por ku është një vendim politikë, me shumë gabime në aspektin procedural, andaj ne jemi kundër.

Pasi që diskutime tjera nuk pati Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për aprovim në parim për diskutim publikë 'Propozimin për ndryshim-plotësimin e Rregullores për organizimin kompetencat dhe përgjegjësitë e organeve të Administratës Komunale'.

U votua me: pesëmbëdhjetë vota 'për', dhjetë vota 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej njëzet e pesë anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me shumicë të votave e aprovoi në parim për diskutim publikë 'Propozimin për ndryshim-plotësimin e Rregullores për organizimin kompetencat dhe përgjegjësitë e organeve të Administratës Komunale' dhe mori:

V E N D I M

Për aprovimin në parim të Propozimit Nr. 150, të datës 15.03.2022, për ndryshim-plotësimin e Rregullores Nr. 125, të datës 25.09.2014, për organizimin kompetencat dhe përgjegjësitë e organeve të Administratës Komunale dhe dërgimin e saj në procedurën e diskutimit publik.

Pika e katërt (4) - Propozim për themelimin e Komitetit për Planifikim Urban Infrastrukturë dhe Shërbime Publike.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Në mbledhjen e kaluar të Kuvendit të Komunës i kemi themeluar tre komitete tjera, tani në rendin e ditës i kemi edhe dy komitete, ju e keni të ditur formulën që e kemi aplikuar, për realizimin e gjithëpërfshirjes së anëtarëve të Kuvendit të Komunës në këto komitete tjera funksionale, me pajtimin e subjektit më të madh politikë në Kuvendin e Komunës Lidhjes Demokratike të Kosovës. Tani ju ftoi që të jepni emrat edhe për këto dy komitete tjera.

Remzi Shala: Në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentarë të Lidhjes Demokratike të Kosovës, për anëtarë të Komitetit për Planifikim Urban Infrastrukturë dhe Shërbime Publike e propozojmë znj. Leona Bërbatovci dhe z. Fisnik Sllamniku, ndërsa në Komitetin për Bujqësi Mjedis dhe Ujëra z. Krenar Dumani.

Durim Hajra: Në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentarë të Lëvizjes Vetëvendosje, për anëtarë të Komitetit për Planifikim Urban Infrastrukturë dhe Shërbime Publike e propozojmë z. Habib Mekolli.

Pasi që diskutime tjera nuk pati Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për aprovim 'Propozimin për themelimin e Komitetit për Planifikim Urban Infrastrukturë dhe Shërbime Publike', në përbërje prej pesë anëtarëve si vijon: Fisnik Sllamniku, Leona Bërbatovci, Habib Mekolli dhe dy anëtarë ekspertë të fushës që jepen nga Ekzekutivi i Komunës. U votua unanimisht nga të pranishmit, gjithsej njëzet e pesë anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me unanimitet të votave e aprovoi 'Propozimin për themelimin e Komitetit për Planifikim Urban Infrastrukturë dhe Shërbime Publike', në përbërje prej pesë anëtarëve si vijon: Fisnik Sllamniku, Leona Bërbatovci, Habib Mekolli dhe dy anëtarë ekspertë të fushës që jepen nga Ekzekutivi i Komunës dhe mori:

V E N D I M

1. Për themelimin e Komitetit për Planifikim Urban Infrastrukturë dhe Shërbime Publike në Komunën e Fushë-Kosovës, në përbërje prej: pesë (5) anëtarëve si vijon:
 - 1.1 Fisnik Sllamniku - përfaqësues i Kuvendit të Komunës nga Lidhja Demokratike e Kosovës, anëtar;
 - 1.2 Leona Bërbatovci - përfaqësuese e Lidhjes Demokratike të Kosovës, anëtare;
 - 1.3 Habib Mekolli - përfaqësues i Kuvendit të Komunës nga Lëvizja Vetëvendosje, anëtar;
 - 1.4 Agnesa Breznica - anëtare dhe
 - 1.5 Shemsi Kelmendi - anëtar.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Komitetit për Planifikim Urban Infrastrukturë dhe Shërbime Publike janë të definuara në nenin 6, të Rregullores Nr. 04, të datës 12.01.2017 për përbërjen dhe kompetencat e Komiteteve tjera.

Pika e pestë (5) - Propozim për themelimin e Komitetit për Bujqësi Mjedis dhe Ujëra.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Pas sqarimeve për anëtarë të Komitetit për Bujqësi Mjedis dhe Ujëra, ë qiti në votim për aprovim 'Propozimin për themelimin e Komitetit për Bujqësi Mjedis dhe Ujëra', në përbërje prej pesë anëtarëve si vijon: Krenar Dumani, Hasan Ismajli, Bashkim Krasniqi dhe dy anëtarë ekspertë të fushës që jepen nga Ekzekutivi i Komunës.

U votua unanimisht nga të pranishmit, gjithsej njëzet e pesë anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me unanimitet të votave e aprovoi 'Propozimin për themelimin e Komitetit për Bujqësi Mjedis dhe Ujëra', në përbërje prej pesë anëtarëve si vijon: Krenar Dumani, Hasan Ismajli, Bashkim Krasniqi dhe dy anëtarë ekspertë të fushës që jepen nga Ekzekutivi i Komunës dhe mori:

V E N D I M

1. Për themelimin e Komitetit për Bujqësi Mjedis dhe Ujëra në Komunën e Fushë-Kosovës, në përbërje prej: pesë (5) anëtarëve si vijon:
 - 1.1 Krenar Dumani - përfaqësues i Kuvendit të Komunës nga Lidhja Demokratike e Kosovës, anëtar;
 - 1.2 Hasan Ismajli - përfaqësues i Kuvendit të Komunës nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, anëtare
 - 1.3 Bashkim Krasniqi - përfaqësues i Kuvendit të Komunës nga Iniciativa e Fushë-Kosovës për Ashkali dhe Egjiptian dhe Zëvendës Kryesues i Kuvendit të Komunës për Komunitete, anëtar
 - 1.4 Lirije Thaqi Xhigoli - anëtare dhe
 - 1.5 Hava Avdullahu - anëtare.
2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Komitetit për Bujqësi Mjedis dhe Ujëra janë të definuara në nenin 10, të Rregullores Nr. 04, të datës 12.01.2017 për përbërjen dhe kompetencat e Komiteteve tjera.

Pika e gjashtë (6) - Propozim për formimin e Komisionit për emërtimin e rrugëve.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Komisioni për emërtimin e rrugëve, është themeluar edhe në mandatin e kaluar, por nuk kanë punuar, tani duhet ta formojmë një Komision të ri të lidhur, me mandatin zgjedhor 2021/2025. Hap diskutimin.

Remzi Shala: Tani ne për anëtarë të Komisionit për emërtimin e rrugëve në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës, në emër të Grupit Parlamentarë të Lidhjes Demokratike të Kosovës, i propozojmë znj. Vjollca Konjusha dhe z. Jahush Krasniqi.

Durim Hajra: Në emër të Grupit Parlamentarë të Lëvizjes Vetëvendosje, për anëtar të Komisionit për emërtimin e rrugëve, e propozojmë z. Shpend Bardiqi.

Mirsad Qyqalla: Në emër të Grupit Parlamentarë të Partisë Demokratike të Kosovës, për anëtar të Komisionit për emërtimin e rrugëve, e propozojmë znj. Aida Alimi.

Pas sqarimeve dhe diskutimeve për anëtarë të Komisionit për emërtimin e rrugëve u propozuan edhe znj. Qëndresa Ademi dhe nga shoqëria Civile z. Xhevdet Qirriqi, ndërsa pesë anëtarë do të jepen nga Ekzekutivi i Komunës, pas këtyre propozimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, ë qiti në votim për aprovim 'Propozimin për formimin e Komisionit për emërtimin e rrugëve', në përbërje prej njëmbëdhjetë anëtarëve si vijon: Vjollca Konjusha, Jahush Krasniqi, Shpend Bardiqi,

Aida Alimi, Qëndresa Ademi nga Shoqëria Civile Xhevdet Qiriri dhe pesë anëtarë tjerë do të jepen nga Ekzekutivi i Komunës.

U votua unanimisht nga të pranishmit, gjithsej njëzet e pesë anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me unanimitet të votave e aprovoi 'Propozimin për formimin e Komisionit për emërtimin e rrugëve', në përbërje prej njëmbëdhjetë anëtarëve si vijon: Vjollca Konjusha, Jahush Krasniqi, Shpend Bardiqi, Aida Alimi, Qëndresa Ademi nga Shoqëria Civile Xhevdet Qiriri dhe pesë anëtarë tjerë do të jepen nga Ekzekutivi i Komunës dhe mori:

V E N D I M

1. Për formimin e 'Komisionit për emërtimin, plotësimin-ndryshimin e emërimit të rrugëve dhe vendeve tjera publike' në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës, në përbërje prej:
 - 1.1 Vjollca Konjusha - anëtare e Kuvendit, anëtare;
 - 1.2 Jahush Krasniqi - anëtar i Kuvendit, anëtar;
 - 1.3 Shpend Bardiqi - anëtar i Kuvendit, anëtar;
 - 1.4 Aida Alimi - anëtare e Kuvendit, anëtare;
 - 1.5 Qëndresa Ademi - anëtare e Kuvendit, anëtare;
 - 1.6 Samir Shahini - Drejtor për Arsim, anëtar;
 - 1.7 Besnik Shala - Drejtor për Kulturë Rini dhe Sport, anëtar;
 - 1.8 Ejup Qyqalla - Shef i Shërbimeve Publike, anëtar;
 - 1.9 Antigona Sahiti - Shefe e Planifikimit Urban, anëtare;
 - 1.10 Bekim Rexha - Zyrtar për Regjistrimin e Adresave, anëtar;
 - 1.11 Xhevdet Qiriri - Përfaqësues nga Shoqëria Civile, anëtar.
2. Detyrë dhe përgjegjësi e Komisionit, nga pika një (1) e Vendimit është 'Emërtimi i rrugëve të reja, shqyrtimi i ankesave të ndërlidhura me plotësim ndryshimin e emërimit të rrugëve ekzistuese dhe emërtimin e vendeve tjera publike' në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.

Pika e shtatë (7) - Propozim për formimin e Komisionit për zgjedhjen e Zëvendës drejtorit të shkollës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim 'Propozimin për caktimin e anëtarëve të Komisionit për përzgjedhjen e Zëvendës drejtorit të Shkollës Filllore të Mesme të Ulët 'Selman Riza' në Fushë-Kosovë', listën e emrave e keni në propozim. Hap diskutimin.

Vlonjat Hasani: Në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, kemi kërkuar që në komision të përfshihet edhe opozita, përmes një Komisioni mbikqyrës, për ta monitoruar procesin e zgjedhjes së drejtorëve të shkollave, ky propozim ka qenë në mbledhjen e muajit janar 2022, por nuk është përkrahur nga pushteti aktual, andaj ne ju ftojmë që këtë ta bëni tani.

Mirsad Qyqalla: Dje në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa u sqaruam se kjo punë është sipas Udhëzimit Administrativ Nr. 151/2020, mirë, ju votat i keni dhe mund ta votoni, por ne kemi kërkuar, që ta kemi edhe një Komision mbikqyrës nga Kuvendi i Komunës, roli i të cilit është minimal, sepse nuk është vendimarrës, vetëm e monitoron zgjedhjen e Zëvendës drejtorit të shkollës, nëse kjo punë nuk bëhet ne jemi kundër.

Durim Hajra: Ne kërkojmë që të respektohen rekomandimet e dalura nga mbledhjet e Komitetit për Politikë dhe Financa dhe ta kemi, edhe një Komision mbikqyrës nga Kuvendi i Komunës, me funksion të monitorimit të punës së zgjedhjes së Zëvendës drejtorit të shkollës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Propozimi në fjalë është në përputhje me dispozitat ligjore të Udhëzimit Administrativ Nr. 151/2022, andaj ju ftoi ta votoni.

Hasan Ismajli: Sipas Udhëzimit Administrativ Nr. 151/2022, është e caktuar mënyra për formimin e Komisionit për zgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve të shkollave, prej tre anëtarëve që marrin vendim dhe dy anëtarëve vëzhgues, që janë njëri përfaqësues i mësimdhënësve të shkollës dhe tjetri përfaqësues i prindërve. Unë nuk e votoi këtë propozim, sepse njëra nga anëtarët e propozuara nuk i plotëson kushtet për të qenë anëtare e Komisionit, ose të paktën neve duhet të na jepen sqarime shtesë nga Drejtoria e Arsimit.

Remzi Shala: Ky problem është shtjelluar bukur mirë në mbledhjen e muajit janar 2022, propozimi është, brenda kornizave ligjore dhe në përputhje me dispozitat e Udhëzimit Administrativ Nr. 151/2022 dhe ne duhet ta aprovojmë. Lidhur me organin mbikqyrës, këtë punë mund ta rregullojmë me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të komiteteve tjera këshilldhënëse, sikur e kemi të themeluar Komitetin për Arsim.

Fisnik Sllamniku: Unë jam punëtorë në arsim dhe i njoh mirë këto rregulla, përbërja e Komisionit duhet të jetë ashtu sikur e cakton Udhëzimi Administrativ, me pesë anëtarë, ku dy prej tyre janë në rolin e vëzhguesit, nuk ka nevojë që Komisioni të ngarkohet me më shumë anëtarë.

Pasi që diskutime tjera nuk pati Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për aprovim 'Propozimin për formimin e Komisionit për zgjedhjen e Zëvendës drejtorit të shkollës'.

U votua me: katërmëdhjetë vota 'për', dhjetë vota 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej njëzet e katër anëtarë pjesëmarrës në votim.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me shumicë të votave e aprovoi 'Propozimin për formimin e Komisionit për zgjedhjen e Zëvendës drejtorit të shkollës' dhe mori:

V E N D I M

1. Për zgjedhjen e anëtarëve të Komisionit për rekrutimin e Zëvendës Drejtorit/es të Shkollës Fillore të Mesme të Ulët 'Selman Riza' në Fushë-Kosovës.
2. Për rekrutimin e kandidatëve për konkursin për Zëvendës Drejtor/e të Shkollës Fillore të Mesme të Ulët 'Selman Riza' në Fushë-Kosovë përzgjidhet Komisioni në përbërje prej tre anëtarëve si vijon:
 - 2.1 Miranda Sylejmani - anëtare e Komisionit, përfaqësuese e Drejtorisë Komunale të Arsimit;
 - 2.2 Sadri Emmini - Zëvendës drejtor në Shkollën Fillore të Mesme të Ulët 'Mihal Grameno', aneksi i shkollës në lagjen e Dardanisë në Fushë-Kosovë;
 - 2.3 Arian Mustafa - anëtar i Komisionit, nga Ministria e Arsimit Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit;
 - 2.4 Krenare Azizi - në cilësinë e vëzhguesit;
 - 2.5 Gazmend Bekolli - në cilësinë e vëzhguesit;

Pika e tetë (8) - Propozim për lirim të subjekteve afariste nga taksat e biznesit për vitin 2022.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim 'Propozim për lirim të subjekteve afariste, që e zhvillojnë veprimtarinë ekonomike në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës nga taksat e biznesit për vitin 2022'. Hap diskutimin.

Habib Mekolli: Tani Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe Tatim në Pronë, propozon lirim të bizneseve nga taksat komunale për pesë vite rreshtë, duke filluar nga viti 2017-2021, të njëjtin lirim e propozon edhe për vitin 2022, për arsye të ndikimit të pandemisë dhe kushteve të vështira për operim të subjekteve afariste. Pse komuna e bënë lirim të bizneseve nga tatimi në pronë, e nuk e heq tatimin në pronë edhe për qytetarë, i cili fillon me 0.5 deri 0.15, meqë ne si komunë, jemi duke i bartur si mjeteve financiare të pa shpenzuara shumë prej pesë milion eurove, kur edhe për qytetarë ka patur shtrenjtim të produkteve bazike, p.sh për një litër vaj çmimi ka shkuar në 3.49 euro, veprimet e komunës duhet të jenë si për qytetarët, ashtu edhe për biznese.

Mirsad Qyqalla: Ne jemi të vetëdijshëm se bizneset, janë duke kaluar në një krizë ekonomike, njëherë pandemia tani edhe kriza ekonomike e këtij viti, por këtu duhet të bëhet një selektim, thuhet se rreth 78% të bizneseve janë mikrobiznese, biznese të vogla, që e kanë shumë të vështirë mbi jetesën në treg, por për ne nuk është e arsyeshme që të veprojmë njësoi edhe për bizneset e mëdha, madje disa prej tyre si: marketet e mëdha dhe pompat e derivative të naftës, kanë patur edhe fitim më të madh në dy vitet e kaluara, për çudi këto biznese janë subvencionuar edhe nga shteti. Ne jemi që bizneset të lirohen nga taksat e biznesit, por jo edhe bizneset e mëdha që janë shumë profitabile, sepse ato edhe nuk kanë nevojë të lirohen, kur e kanë qarkullimin e madh ekonomik.

Hasan Ismajli: E dijmë se bizneset janë liruar nga taksat e bizneseve për disa vite me radhë, por kanë mbetur shumë borxhe të pa inkasuara prej bizneseve nga vitet paraprake, unë pyes, a ka mundësi që këto biznese të falen dhe të nisemi prej zeros.

Durim Hajra: Shumica u thanë, neve që nga viti 2018, ku bizneset lirohen nga taksat komunale pa përjashtim, ne vjen një fletë A4, pa një sqarim për numrin e biznesve funksionale, ndikimin e lirit nga taksat e biznesit, pra kjo punë deri tani është bërë për vite me radhë njësoi, pa kurfare analize ekonomike nga komuna, kjo punë kështu është shumë jo serioze. Ne në parim jemi për lirim të bizneseve nga taksat komunale, për arsye të pandemisë dhe krizës ekonomike që po kalojmë, për është një obligim moral që ta bëjmë një ndarje të tyre, pajtohemi që bizneset e vogla kanë nevojë për përkrahje nga komuna, por bizneset e mëdha, e kanë edhe profitin e madhë, nuk kanë nevojë që të lirohen nga taksa komunale prej qindra eurove, apo njëmijë eurove.

Remzi Shala: Propozimi për lirim të biznesve nga taksat komunale, është i arsyeshëm, meqë mbi 80% e bizneseve janë mikrobiznese, që e kanë të vështirë, të funksionojnë në këtë kohë, janë goditur edhe nga pandemia, që tani jemi edhe në vitin e tretë të saj. Ne nuk jemi që të bëjmë ndarjen e bizneseve, komuna duhet të gjen forma tjera të përkrahjes së tyre.

Shpend Bardiqi: Këtu ka rëndësi të madhe klasifikimi i bizneseve, pse të lirohen bizneset e mëdha që kanë shumë borxhe ndaj komunës, disa prej tyre duhet edhe të dënohen, ju po e shihni si i kanë rritur çmimet e biletave vetë, në relacionin Bardh i Madh/Fushë-Kosovë. Nëse nuk bëhet

klasifikimi i bizneseve nëpër kategori, kjo është një pa përgjegjësi, sepse disa biznese kanë mjaftueshëm profitë ekonomik dhe nuk ka nevojë të lirohen nga taksat e biznesit.

Driton Ademi: Komuna i ka tre shtylla dhe njëra nga to është përgjegjësia për nxitjen e zhvillimit ekonomik lokal, kjo punë bëhet përmes krijimit të kushteve dhe favorizimeve për subjektet afariste, është mirë që ne po i lirojmë bizneset nga taksat komunale, sepse e kanë kaluar një periudhë të vështirë gjatë pandemisë, shumica e bizneseve tona. Lirimi nga taksat komunale e nxitë, edhe rritjen e mirëqenies sociale, përmes punësimit të punëtorëve të rinjë.

Drejtori për Zhvillim Ekonomik: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Ne ju falënderojmë të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës, që dhanë kontributin e tyre për temën në fjalë, ne kemi synuar përherë që ta kemi një partneritet me bizneset, që operojnë në territorin e komunës tonë dhe besojmë se jemi shndërruar, në komunë atraktive për të bërë biznes, për arsye të eliminimit të burokracisë dhe krijimit të lehtësimeve tjera për vite me radhë. Edhe kërkesa për klasifikimin e bizneseve, është e arsyeshme dhe këtë punë do ta bëjmë gjatë këtij vitit, përmes ndryshimit të Rregullores për tarifa ngarkesa dhe gjoba komunale. Falja e borxheve është një temë tjetër të cilën mund ta trajtojmë, në mbledhjen e ardhshme. Sa i përket tatimit në pronë, ne nuk e kemi të drejtën të heqim këtë të hyrë komunale, në vitin e kaluar kemi patur një rritje të inkasimit prej 66%, për herë të parë nga tatami në pronë, janë grumbulluar mbi një milion euro, duke ju falënderuar punës korrekte të punëtorëve dhe qytetarëve që i kanë kryerë obligimet ndaj komunës. Lirimi i bizneseve nga taksat komunale nuk e pengon zhvillimin e komunës, sepse ne kemi të hyra të mira nga lejet e ndërtimit dhe tatimi në pronë.

Pasi që diskutime tjera nuk pati Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për aprovim 'Propozimin për lirimin e subjekteve afariste nga taksat e biznesit për vitin 2022'.

U votua unanimisht nga të pranishmit, gjithsej njëzet e pesë anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me unanimitet të votave e aprovoi 'Propozimin për lirimin e subjekteve afariste nga taksat e biznesit për vitin 2022' dhe mori:

V E N D I M

Për aprovimin e Propozimit Nr. 239, të datës 15.03.2022, për lirimin e bizneseve nga pagesa e taksës komunale për vitin 2022, për të gjitha subjektet afariste që ushtrojnë veprimtarinë e tyre ekonomike dhe biznese në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës, në funksion të krijimit të lehtësimeve për bizneset ekzistuese dhe avantazhe për hapjen e bizneseve të reja dhe gjenerim të punësimit.

Pika e nëntë (9) - Informatë krahasuese për gjendjen e përgjithshme të sigurisë nga Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për analizim një 'Informatë krahasuese për gjendjen e përgjithshme të sigurisë nga Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi', për tre vitet e kaluara 2019, 2020 dhe 2021, e cila ju shërben për të dhëna dhe statistika.

Pika e dhjetë (10) - Të ndryshme: Shqyrtimi i rekomandimeve të Komitetit për Politikë dhe Financa, lidhur me rishqyrtimin e vendimeve si vijon:

Vendimi Nr. 22 për themelimin e tre Drejtorateve të reja Komunale,

Vendimi Nr. 21, për emërimin e z. Suhat Ademi në pozitën e Nënkrjetarit të Komunës për Komunitete dhe

Vendimit Nr. 55 për dhënien në shfrytëzim për raste të veçanta të pronës komunale për ndërtimin e Statcionit të Policisë në Komunën e Fushë-Kosovës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Tani meqë është shumë e qartë procedura dhe e kemi kërkesën e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, për shfuqizimin e vendimit Nr. 22, të datës 07.02.2022, e qiti në votim 'Propozimin për shfuqizimin e vendimit për themelimin e tre Drejtorateve të reja Komunale.

U votua unanimisht nga të pranishmit, gjithsej njëzet e pesë anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me unanimitet të votave e aprovoi 'Propozimin për shfuqizimin e vendmit për themelimin e tre Drejtorateve të reja Komunale' dhe mori:

V E N D I M

Për shfuqizimin e vendimit Nr. 22, të datës 07.02.2022, sipas shkresës së Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal Nr. 020-144/5, të datës 24.02.2022 dhe Rekomandimeve të dalura nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, me Nr. 83, të datës 24.03.2022, lidhur me aprovimin e Propozimit Nr. 23 të datës 20.01.2022, për themelimin e tre Drejtorateve të reja të Komunës së Fushë-Kosovës.

Pika tjetër ka të bëjë me rishqyrtimin e vendimit për emërimin e z. Suhat Ademi në pozitën e Nënkrjetarit të Komunës për Komunitete. Hap diskutimin.

Remzi Shala: Për këtë vendim është nevojitur shumica e dyfishtë, andaj ne nuk jemi për shfuqizimin e tij, pa arrijten e dakordimit ndërmjet komuniteteve jo shumicë, sepse nuk mund ta marrim vendimin në aspektin procedural, pa pjesëmarrjen në votim të komuniteteve jo shumicë, ku dy përfaqësues të tyre mungojnë në mbledhjen e sotne.

Hasan Ismajli: Sipas regjistrimit për zgjedhje në Komisionin Qendrorë të Zgjedhjeve, këta kanë të drejtë, sugjerimi im është që ta marrim edhe një mendim profesional nga Komisioni Komunal Zgjedhor, për regjistrimin e kësaj Iniciative të komuniteteve në zgjedhjet lokale, pastaj të vendosim për çështjen në fjalë.

Durim Hajra: Vendimi është kthyerë nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, për arsye se personi në fjalë nuk i takon komunitetit ashkalinjë, që është më i madhi për nga numri i banorëve në komunën tonë, nga komunitetet jo shumicë, ky është thelbi i problemit dhe ne e kemi obligim, që ta shfuqizojmë këtë vendim, andaj kërkoj që të hedhet në votim, përndryshe jemi në kundërshtim me ligjin dhe udhëzimin administrativ.

Nënkrjetari i Komunës: Ligji është për të dy palët, këtu ka një dallim ndërmjet ligjit dhe udhëzimit administrativ, i cili nuk është i harmonizuar me ligjin, ne këtu i kemi dy përfaqësues nga subjekti i egjiptianëve, pra iniciativa e tyre, andaj ne duhet të vazhdojmë kështu, nëse këta nuk e arrijnë një ujdi për zgjidhjen e problemit, ju e dini sa kohë kemi humbur në mandatin e kaluar.

Opinionimi im dhe i Lidhjes Demokratike të Kosovës, është se duhet të anulohet ky udhëzim administrativ, sepse ka një dualitet në dispozitat e tij.

Durim Hajra: Ne këtu jemi duke e kundërshtuar pa arsye konstatimin e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, që është i bazuar në dispozitat e Udhëzimit Administrativ, të nenit dhe pikës së caktuar, andaj qëndrimi ynë është që ky vendim të shfuqizohet.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Për këtë çështje vendos Kuvendi i Komunës me votim.

Shpend Bardiqi: Është tendencioz propozimi që të mos shfuqizohet vendimi i paligjshëm, kur z. Suhat Ademi vetë vitin e kaluar e ka deklaruar përkatësinë etnike si egjiptian, ne duhet të veprojmë në përputhje me dispozitat ligjore, që e rregullojnë këtë punë.

Driton Ademi: Vendimet në Kuvend vijnë për rishqyrtim, është Kuvendi i Komunës, i cili vendos për secilën çështje, ku mund ta kërkon edhe një afatë shtesë prej tridhjetë ditëve për harmonizimin e vendimit.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve tjera Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim 'Propozimin për shfuqizimin e vendimit për emërimin e z. Suhat Ademi në pozitën e Nënkrjetarit të Komunës për Komunitete'.

U votua me: dhjetë vota 'për' dhe trembedhjetë vota 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej njëzet e tre anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me shumicë të votave e lën në fuqi vendimin për emërimin e z. Suhat Ademi në pozitën e Nënkrjetarit të Komunës për Komunitete dhe mori:

V E N D I M

Vendimi për emërimin e z. Suhat Ademi në pozitën e Nënkrjetarit të Komunës për Komunitete, i datës 07.02.2022 mbetet në fuqi, pas rishqyrtimit të kërkesës Nr. 020-144/4 të datës 22.02.2022.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Tani duhet ta plotësojmë vendimin për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim, për raste të veçanta dhe duhet ta definojmë periudhën kohore prej nëntëdhjetë e nëntë viteve. Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim 'Propozimin për ndryshimin e vendimit për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim për raste të veçanta'.

U votua me: njëzet e një vota 'për', asnjë votë 'kundër' dhe katër abstenime, gjithsej njëzet e pesë anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës me shumicë të votave e aprovoi 'Propozimin për ndryshimin e vendimit për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim për raste të veçanta' dhe mori:

V E N D I M


1. Për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale të Komunës së Fushë-Kosovës për Statcionin e Policisë sipas rasteve të veçanta, me numër të certifikatës së pronës P-72514036-00696-0, në Zonën Kadastrale në Fushë-Kosovë, me destinim për ndërtimin e Statcionit të Policisë në Fushë-Kosovë.

2. Dhënia e pronës komunale në shfrytëzim bëhet për nëntëdhjetë e nëntë vite, për institucionin e Ministrisë së Punëve të Brendshme - Stacionin e Policisë në komunën tonë.
3. Qëllimi i dhënies së pronës komunale në shfrytëzim, është ndërtimi i Stacionit të ri të Policisë në Komunën e Fushë-Kosovës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës falënderoi të pranishmit për pjesëmarrje në mbledhje. Mbledhja përfundoi në ora 14:15 minuta.

Procesmbajtës

Hasan Gjyrevci



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Ali Ismaili

